



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1545/3 Prot.

Tiranë, më 02.12.2024

V E N D I M

**Nr. 287, datë 02.12.2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 236, datë 12.11.2024, nga Shoqata e Ish-Të Përndjekurve Politikë kundër Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, “*gjendjes shoqërore*”, “*përkatësisë në një grup të veçantë*” dhe “*çdo shkak tjetër*”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, pala ankuese, ndër të tjera, informon se: *Shoqata e Ish-Të Përndjekurve Politikë nuk ka pasur seli, megjithatë Bashkia e Tiranës kërkoi taksën e truallit dhe të pastrimit etj., në më shumë se 2 (dy) milion lekë të vjetra për këtë padrejtësi (diskriminim klasor). Për këtë arsye, iu drejtuam Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, në bazë të Vendimit nr. 905, datë 19.03.2019, na dha të drejtën, por, pas më shumë se 5 vitesh pritje, nuk është shlyer ai detyrim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Kërkesave tona me shkrim drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit nuk i janë përgjigjur në asnjë rast, duke e bërë të qartë se diskriminimi klasor vazhdon. Shoqata e Ish-Të Përndjekurve Politikë është një shoqatë jo qeveritare, jo partiake dhe jo fitimprurëse. Kjo bashkon ata që u dënuan nga regjimi komunist për motive politike dhe shpesh me akuza të pabaza. Këta njerëz kanë qenë të diskriminuar dhe të përndjekur familjarisht nga regjimi i kaluar dhe aktualisht janë në një gjendje të mjeruar ekonomike. Për këtë shtresë, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur unanimitisht rehabilitimin moral*

*dhe material dhe ligjin për dëshmëpërblim financiar. Për këtë qëllim është krijuar dhe po punon shoqata. Megjithatë, ka zyrtarë me paragjykime komuniste që nuk e shohin me sy këtë shtresë shoqërore dhe, me forma të ndryshme, shpesh dhe haptas, si në rastin tonë, kërkojnë ta pengojnë procesin e rehabilitimit të kësaj shtrese shoqërore fatkeqe.*

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zgjidhjen e problemit për arsyet e parashtruara më lart, duke kërkuar që Komisioneri të ndërhyjë për të na dhënë këtë të drejtë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila po e mban peng prej 5 vitesh.

### **Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Subjekti ankues ka ngritur pretendimin se, nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nuk janë marrë parasysh kërkesat e paraqitura nga Shoqata e Ish-Të Përndjekurve Politikë të Republikës së Shqipërisë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes dhe zgjidhjen e saj në mënyrë përfundimtare.

Në ankesë pretendohet se çështja është ende në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ndonëse ka kaluar një periudhë më shumë se pesë vjeçare nga fillimi i procesit gjyqësor, dhe, sipas legjislacionit në fuqi, kjo periudhë kalon çdo afat të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të tilla. Subjekti kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ndërhyjë për të zgjidhur këtë problematikë dhe për të siguruar një proces gjyqësor të shpejtë dhe të drejtë të çështjes.

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtron veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë. Në nenin 147, pika 1 e Kushtetutës, përcaktohet se: *“Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në Kreun X, "Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmshpërblimit", në nenin 399/1, pika 2, parashikon se:

*"2. Dispozitat e këtij Kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si dhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si dhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve."*

Neni 399/2 "Afati i arsyeshëm", ka parashikuar se:

*1. Afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen si vijon: a) Në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit duhet të ndodhë brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë; b) Në gjykimin civil në shkallë të parë, përfundimi i procesit të gjykimit duhet të bëhet brenda dy viteve, ndërsa në gjykimin civil në apel brenda dy vjetëve; dhe në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, përfundimi i tij duhet të ndodhë brenda dy vjetëve; c) Në*

procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim; ç) Në hetimin e veprave penale, afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve do të përcaktohet sipas Kodit të Procedurës Penale; d) Në gjykimin penal në shkallë të parë, afati për gjykimin e krimeve është 2 vjet dhe për kundërvajtjet është 1 vit; në gjykimin në apel, përfundimi i gjykimit për krimet duhet të bëhet brenda një afati kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet brenda 6 muajsh; dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet duhet të ndodhë brenda një afati kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet brenda 6 muajsh.

2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit.

3. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

Neni 399/6 i Kodit të Procedurës Civile përcakton Gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadisë, ku është parashikuar se:

1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative, si më poshtë:  
a) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, kërkesa shqyrtohet nga gjykata e apelit, në juridiksionin e të cilës ndodhet gjykata e shkallës së parë; b) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë; c) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa shqyrtohet nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë; ç) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjkohet nga gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.
2. Kur ka një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurës, subjekti kërkues mund të paraqesë padi për shpërblimin e dëmit, sipas pikës 3 të këtij neni.
3. Kërkesëpadija për shpërblimin e dëmit i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë, ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja. Padija parashkruhet brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes me vendim të formës së prerë.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se gjykata është organi i vetëm që ka kompetencë për të vendosur lidhur me përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes dhe zgjidhjen e saj në mënyrë përfundimtare. Konkretisht, në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet se ka ndodhur një shkelje, është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë.

Sipas legjislacionit në fuqi, ankesat lidhur me çështjet që janë në gjykim mund të shqyrtohen përmes kontrollit gjyqësor, duke iu drejtuar Këshillit të Lartë të Gjyqësor<sup>1</sup> apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë<sup>2</sup>, të cilët janë organet kompetente për shqyrtimin e ankesave në përputhje me parimet e drejtësisë dhe dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Inspektorati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve gjyqësore, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>3</sup>.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>1</sup> Neni 147/a, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: *“Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve”*.

<sup>2</sup> Neni 147/d, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: *“Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”*.

<sup>3</sup> Për analogji citojmë Vendimet nr. 132, datë 04.07.2022, të KMD-së.

## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga Shoqata e Ish-Të Përndjekurve Politikë pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**